



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Seancë e jashtëzakonshme e Kuvendit

P-083

Prishtinë, më 20 dhjetor 2016

PROCESVERBAL

**I SEANCËS SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 20 DHJETOR 2016**

Seancën e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga nënkryetarët e Kuvendit, Sabri Hamiti dhe Xhavit Haliti.

Kryetari i hapi punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2016.

Ai procedoi me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Debat parlamentar lidhur me rastin “Astrit Dehari”, sipas kërkesës së 40 deputetëve nënshkrues

Kryetari i njoftoi deputetët se grupi prej 40 deputetëve nënshkrues, mbështetur në nenin 69.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 38 të Rregullores së Kuvendit kanë parashtruar kërkesë për seancë të jashtëzakonshme lidhur me rastin “Astrit Dehari”.

Kryetari e ftoi kryetarin e GP PDK, Zenun Pajaziti që në emër të 40 deputetëve të Kuvendit, parashtrues të kërkesës për debat parlamentar, ta marrë fjalën.

Kryetari i GP PDK, z. Zenun Pajaziti, e paraqiti dhe arsyetoi kërkesën për debat parlamentar lidhur me rastin e vdekjes së Astrit Dehari në Qendrën e Paraburgimit në Prizren. Ai, ndër të tjera, tha se nëse familja nuk pajtohet me raportet e organeve kompetente rreth vdekjes së Astrit Deharit, si Kuvend dhe si institucione jemi të gatshëm të mbështesim hetime tjera, goftë nga ekspertë vendorë apo ndërkombëtarë, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript. Kryetari, pas diskutimit të z. Zenun Pajaziti, e hapi debatin lidhur me rastin “Astrit Dehari”.

Lidhur me rastin e vdekjes së Astrit Dehari diskutuan: Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të LVV-së; Pal Lekaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Valedete Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma” dhe ministrja e Drejtësisë; Dhurata Hoxha, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Për rastin “Astrit Dehari” në debatin parlamentar diskutuan deputetët: Labinotë Demi-Murtezi, Glauk Konjufca, Melihate Tërmkollo, Valdete Bajrami, Driton Çausi, Enver Hoti, Ilir Deda, Agim Aliu, Besa Gaxheri, Mytahir Haskuka, Shukrije Bytyqi, Selvije Halimi, Arben Gashi, Albulena Haxhiu, Zafir Berisha, Nezir Çoçaj, Vjosa Osmani, Donika Kadaj Bujupi, Hajdar Beqaj, Nuredin Ibishi, Besa Baftiu, Safete Hadërgjonaj, Rexhep Selimi, Zenun Pajaziti, Ismet Beqiri, Mexhide Mjaku-Topalli, Ismajl Kurteshi, Emilija Rexhepi, Aida Dërguti, Nait Hasani, Shqipe Pantina, Gëzim Kelmendi, Abdyl Ymeri, Albin Kurti, Xhevahire Izmaku, Visar Ymeri, Bislim Zogaj, Bekim Haxhiu, Blerta Deliu Kodra, Fisnik Ismajli dhe Hajrdar Beqaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryetari e ftoi z. Zenun Pajaziti, kryetar i GP të PDK-së, që para deputetëve t’i paraqesë rekomandimet e debatit parlamentar për rastin “Astrit Dehari”.

Z. Pajaziti i lexoi rekomandimet në cilësinë e propozuesit të debatit.

Pastaj kryetari kërkoi nga kryetarët e grupeve parlamentare të deklarohen rreth propozim-rekomandimeve të paraqitura nga kryetari i GP PDK, Zenun Pajaziti.

Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së i përkrahu rekomandimet e propozuara nga z. Pajaziti.

Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të LVV-së, e propozoi një Projekt-rezolutë prej tri pikave, të cilat, sipas tij, janë edhe kërkesat e Peticionit të shoqërisë civile, si në vijim:

1. Hetim të pavarur dhe transparent për rastin e vdekjes së Astrit Deharit në Burgun e Prizrenit,
2. Dorëheqjen e udhëheqësve të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme për mosgatishmërinë morale e ligjore për të kërkuar dhe dhënë përgjegjësi për vdekjen e Astrit Deharit.
3. Fillimin e menjëhershëm të ndjekjes penale të përgjegjësve që dështuan ta garantojnë sigurinë e jetës së Astritit në institucionet e shtetit dhe shkarkimin e zyrtarëve përgjegjës në tërë zinxhirin hierarkik për mostrajtimin dinjitoz të Astritit në Qendrën e Paraburgimit edhe pas vdekjes së tij.

Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, dhe Zafir Berisha, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”, shprehën përkrahjen e tyre për pikat e propozuara në Peticionin e qytetarëve.

Kryetari i Kuvendit deklaroi se në votim do t’i hedhë rekomandimet e propozuara nga kryetari i GP PDK, Zenun Pajaziti edhe Propozim-rezolutën e propozuar nga kryetari i GP LVV, Glauk Konjufca.

Kryetari i hodhi në votim rekomandimet e GP të PDK-së.

Rezultati i votimit për rekomandimet e propozuara nga kryetari i G/P të PDK-së ishte, si në vijim:

Për -----	49
Kundër -----	0
Abstenime -----	13

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash i miratoi rekomandimet e propozuara nga Grupi Parlamentar i PDK-së, si në vijim:

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës, me qëllim të mbrojtjes së Kushtetutës dhe vlerave kushtetuese të Republikës së Kosovës edhe një herë shpreh përkushtimin e vet që në Republikën e Kosovës të gjithë të jenë të barabartë para ligjit dhe secili individ ta gëzojë të drejtën për jetë.
2. Vdekja e shtetasit të Republikës së Kosovës në Burgun e Prizrenit, Astrit Dehari, e cila ka sjellë reagime deri në politizim të skajshëm, duhet të zbardhet në mënyrë transparente dhe të mos u lihet hapësirë manipulimeve politike.
3. Kuvendi i fton të gjitha institucionet përgjegjëse që t'i ndërmarrin masat e duhura në kuadër të kompetencave ligjore dhe të mos lënë as një pikë dyshimi në këtë rast.
4. Familja Dehari, në rast të dyshimeve në ekspertizat e institucioneve përgjegjëse, mund të kërkojë nga Qeveria e Kosovës që të bëjë ekspertiza shtesë edhe jashtë vendit, nga cilido vendi i BE-së dhe SHBA-ve që ajo dëshiron. Me këtë rast, Qeveria e Kosovës duhet t'i mbulojë shpenzimet për çdo ekspertizë shtesë.

Pastaj, e hodhi në votim Propozim-rezolutën e GP të LV.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	20
Kundër -----	17
Abstenime -----	25

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi Propozim-rezolutën e propozuar nga kryetari i GP të Lëvizjes Vetëvendosje.

Kryetari i mbylli punimet e seancës së jashtëzakonshme në orën 16:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*